

www.fppsigal.com.al



KODI I ETIKËS



Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit

E ardhmja jonë së bashku!

Përmbajtja

1. Parathënie
2. Menaxhimi i etikës në përputhje me ligjin
 - Anti-Korrupsioni
 - Parandalimi i pastrimit të parave
 - Informacioni/Raportimet
 - Pasojat në raste shkeljeje
3. Rregullat e mirësjelljes
 - Sjellja me klientët
 - Sjellja me partneret e biznesit/ autoritetet publike
 - Marrëdhënia me personelin
4. Pasuria dhe informacioni konfidencial
 - Pasuria dhe pajisjet e kompanisë
 - Mbrojtja e të dhënave / mbrojtja e të dhënave të bizneseve.
5. Konkurenca-Sjellja e Përputhshmërisë
 - Informacioni i brendshëm
6. Konflikti i Interesit
7. Komunikimi
8. Siguria
9. Personat e Kontaktit

/1 Parathënie

Të dashur punonjës,

Detyra më e rëndësishme e SHAFP është ti japë siguri klientëve të saj dhe t'ju siguroje atyre një investim sa me të lartë të kontributeve të tyre në mënyrë që të sigurojnë të ardhmen me Planin e Pensioneve të krijuar nga vete ata.

Bazuar në këtë mision tonin kemi hartuar Kodin e Sjelljes i cili reflekton kulturën e Shoqërisë sonë dhe rregullon përgjegjësinë me klientin, stafin dhe partnerët e biznesit. Kodi ynë i sjelljes duhet të zbatohet nga gjithë stafi i shoqërisë, duke përfshirë dhe Anetaret e Keshillin e Administrimit .

Ky kod ka të njëjtin ndikim tek KA ashtu si tek çdo punonjës i Shoqërisë. Çdo njëri nga ne është përgjegjës për sjelljen e tij dhe pasojat që rrjedhin për Shoqërinë tonë

Në shumë aspekte kodi i mirësjelljes është më strikt se ligji. Kështu që ne hartuam një kod me standard, për një sjellje sa më etike dhe moderne.

Të gjitha rregullat e përkrahura në këtë Kod, iu prezantuan edhe KA dhe janë në zbatim nga të gjithë.

ADMINISTRATOR I PËRGJITHSHËM
SHAFP SIGAL Life UNIQA
ELVIS PONARI

/2 Menaxhimi i etikës në përputhje me ligjin

Ne i kushtojmë rëndësi shumë Prezences sone ne Tregun e Pensioneve Private. Bazuar në këtë , kemi vendosur standard të brendshme për një sjellje sa më etike dhe përdorim liri krijuese deri në atë masë që është në përputhje me ligjin dhe vlerat tona themelore dhe që nuk e dëmtojnë reputacionin e Grupit , SIGAL UNIQA ku ne bejme pjese.

Ne kemi interesa të përbashkëta dhe punojmë shumë për klientët dhe kolegët tanë. Sjellja jonë brenda kompanisë dhe në marrëdhënie me të tretët, është e qartë dhe e ndershme. Ajo çfarë kemi të përbashkët si punonjës të SHAFP qe Administrojme Fondin e Pensioneve Sigal është dëshira për të qënë gjithmonë të parët. Duke ju ofruar klienteve tane nje sherbim cilesor dhe me te mire se konkurentet tane. Duke pasur parasysh këtë qëndrim, ne bëjmë çdo gjë që është e mundur për klientët tanë në mënyrë që të shikojne në mënyrën më optimale të ardhmen e tyre.

Sjellja jonë personale duhet të jetë në të njëjtën linjë me rregullat sociale dhe ligjore. Veprimet dhe sjelljet që mund të dëmtojnë apo prishin reputacionin e Shoqërisë sone nuk janë të pranueshme.

Sjellja e kolegëve në pozicionet drejtuese do të

shërbejë si model për të gjithë stafin dhe kompaninë në tërësi. Këta kolegë duhet të mundësojnë dhe të sigurohen që stafi i tyre është i familjarizuar me Kodin e Sjelljes dhe duhet të mbikqyrin parimet e sjelljes.

Në ambjentin tonë të punës ne nuk lejojmë që askush të përfshihet në aktivitete të jashtëligjshme dhe as nuk tolerojmë veprime të paligjshme.

Në lidhje me këtë, çështjet e mëposhtme kërkojnë vëmendje të veçantë:

Anti-Korrupsioni

Korrupsioni përfshin kërkesën, ofertën ose pranimin e përfitimeve (referuar më së shumti mitmarrjes, rryshfetit të parave ose marrjes së dhuratave).

Koncepti i korrupsionit nuk është përcaktuar qartë. Disa sjellje imorale mund të mos përcaktohen qartë nga ligji kështu që nuk është gjithmonë e qartë nëse një sjellje e caktuar është e jashtëligjshme. Kjo është arsyeja pse secili nga ne duhet të sigurohet që të qëndrojë larg korrupsionit dhe ti raportojë raste të tilla dhe raste të dyshimta eprorëve të tij. Një nga detyrat tona kryesore është të mbrojmë reputacionin e kompanisë.

Parandalimi i pastrimit të parave

Shoqëria jone si pjese e Grupit SIGAL UNIQA , ka marrë të gjitha masat të përcaktuara me ligj për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Në përputhje me këtë qasje ne kemi ndjekur parimin “Njih klientin tënd”; kjo procedurë

pengon kryrjen e transaksioneve të dyshimta dhe anonime.

Informacioni/Raportimet

Nëse ne konstatojmë një shkelje, moszbatim të ligjeve apo shkelje të Kodit të Sjelljes, ne duhet

duhet të informojmë eprorët tanë. Ky informacion mund të dërgohet me e-mail, letër apo me telefon. Informacioni mund të dërgohet në mënyrë shumë personale dhe anonime dhe do të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe me kujdesin e duhur.

Pasojat në raste shkeljeje

Shkelja e rregullave statutores dhe rregullave të etikës mund të çojë në dëmtim të vazhdueshëm të reputacionit të kompanisë. Kjo mund të çojë deri në kërkesa për dëmshpërblim, gjopa administrative, gjopa ose në anulim apo pezullim të lejes apo liçensës. Shoqëria jone do të reagojë dhe veprojë kundrejt çdo mosrespektimi apo shkeljeje. Masat që do të merren në këto raste përbëjnë diskrecionin e Shoqërisë dhe mund të cojnë deri në mbyllje të kontratës së punës dhe pagim dëmshpërblimi.

/3

Rregullat e mirësjelljes

Mënyra e sjelljes me klientët, partnerët dhe kolegët tanë është shumë e rëndësishme për ne. Ajo bazohet në besim dhe është ngushtësisht e lidhur me modelin tonë të biznesit. Prandaj mënyra e sjelljes me klientët, partnerët dhe kolegët me njëri-tjetrin të jep përshtypjen e një kompanie qartësisht të kuptueshme, si brenda ashtu dhe jashtë saj.

Në bashkëbisedimet me stafin, klientët dhe partnerët ne përdorim ton të sjellshëm dhe të respektueshëm dhe shprehim dukshëm shmangien apo nënvlerësimin ndaj njëri-tjetrit, nuk tolerojmë asnjë diskriminim të çfarëdo lloji qoftë si nga origjina etnike, raca, gjinia, besimi fetar,

ideologjia, paaftësia apo orientimi seksual në ambientet brenda apo jashtë kompanisë. Pjesë e stilit tonë të punës, të marrëdhënies me kolegët, eprorët, klientët, partnerët, autoritetet publike dhe të tjerët, është një sjellje e respektueshme, e besueshme, e drejtë dhe me theksin tek puna e skuadrës.

Sjellja me klientët

Ne i zhvillojmë marrëdhëniet me klientët mbi bazën e besimit reciprok. Ju japim këshillat më të mira klientëve tanë.

Ne i kryejmë pagesat, sipas kërkesave të klienteve, në mënyrën me korrekte, kompetente dhe më të shpejtë të mundshme, Fokusi ynë në punën e përditshme është gjetja e zgjidhjeve për klientët tanë dhe i këshillojmë klientët tanë me kujdesin maksimal në mënyrë që të plotësojnë nevojat e tyre afatgjata. Megjithatë ne shfaqim sjellje me integritet dhe përgjegjësi, klientët dhe partnerët tanë mund të ndjejnë që nuk po trajtohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Që të arrijmë këtë parim themelor ne kemi hartuar një sistem për të menaxhuar kërkesat dhe ankesat e klientëve. Ne i japim zgjidhje ankesave dhe problemeve që kanë klientët dhe partnerët tanë në mënyrë shoqërore, kompetente, dhe të shpejtë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi. Orientimi drejt klientit është çelësi i suksesit tonë. Çdo punë që ne bëjmë është e përqendruar tek klienti. Klientët tanë presin siguri nga ne. Ne japim ndihmë në rast emergjence dhe sillemi në mënyrë të matur. Edhe në proceset e brendshme, fokusi është tek shërbimi dhe ne mbështesim klientët dhe kolegët tane deri në maksimumin e mundshëm. Pjesëtarët e stafit të cilët janë në kontakt të vazhdueshëm me klientët dhe partnerët e biznesit duhet ti kushtojnë rëndësi të veçantë veshjes së tyre. Stafit i kërkohet që të vishen në mënyrë të përshtatshme, në përputhje me pozicionin e punës së tyre. Duhet të tregohemi të sjellshëm edhe nëse një klient psh. -ka telefonuar dhe po shpreh zemërimin e tij për faktin që atij i kërkohet mjet identifikimi përpara se të marrë shumën nga kontrata e pensionit dhe

kur kjo gjë kërkohet me ligj,

Ne me qetësi duhet ta informojmë klientin për kërkesat ligjore dhe të detyrueshme edhe pse kjo gjë na shpenzon kohë.

-Ose psh. nëse Unë jam pjesë e stafit dhe paraqitem në një nga zyrat e shërbimit, për disa procedura dhe në prezencë të klientëve, dy kolegë të stafit po debatojnë me zë të lartë atehere :

Unë do ju them kolegëve të mi në mënyrë të sjellshme por të prerë që nuk duhet të trajtojnë problemet e brendshme të Shoqërisë në vendin ku presin klientët.

Sjellja me partneret e biznesit/ autoritetet publike

Ne të gjithë kemi përfitime dhe avantazhe nga një marrëdhënie biznesi e qëndrueshme dhe afatgjatë. Marrëdhëniet me partnerët tanë të biznesit janë çelësi i suksesit dhe duhet të jenë rezultat i parimeve tona, kënaqësi e ndërsjelltë dhe bashkëpunim i ndërsjelltë për të patur një partneritet sa më efektiv.

Marrëdhënia me personelin

Ne jemi plotësisht të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë tonë sociale dhe veprojmë në përputhje me dispozitat për sigurinë dhe shëndetin në punë, ligjin për kontratat e punës dhe respektimin e të drejtave të personelit. Performanca në punë, kapaciteti, përpjekjet dhe vullneti i mirë janë kriteret kryesore për karrierë dhe zhvillim të mëtejshëm.

/4

Pasuria dhe informacioni konfidencial

Pasuria dhe pajisjet e kompanisë

Si rregull, pasuria e Shoqërisë dhe e Fondit të Pensioneve mund të përdoret vetëm për qëllime biznesi. Ne mbrojmë këto pasuri nga vjedhja, humbja dhe keqpërdorimi. Krahas asetëve materiale dhe fizike si burime operative, pasuria e Shoqërisë dhe e Fondit përfshin gjithashtu asetet e paprekshme si pasuria intelektuale duke përfshirë licencat e programeve kompjuterike. Ne respektojmë rregullat e brendshme mbi përdorimin e burimeve operative (e cila përfshin por nuk kufizohet) Informacioni që ia vlen të ruhet është i procesuar në godinën e Drejtorisë së Përgjithshme. Nga njëra anë ne kemi informacion të detajuar për jetën e klientëve tanë por nga ana tjetër, procedurat dhe metodat janë një aset i cili në rast se zbulohet mund të kthehet në disavantazh për ne.

Mbrojtja e të dhënave / mbrojtja e të dhënave të bizneseve.

E drejta e privatësisë është konsideruar një e drejtë njerëzore dhe si e tillë duhet të mbrohet. Ne duhet të jemi në përputhje me masat për mbrojtjen e të dhënave dhe japim garanci që këto të dhëna personale (të dhënat që i përkasin qartësisht një personi të caktuar) janë seriozisht të mbrojtura kundër veprimeve dhe ndërhyrjeve të paautorizuara. Këto të dhëna mund të jepen vetëm për qëllime të justifikuara. Kur të dhënat e klientëve janë të mbledhura dhe të procesuara, të drejtat themelore, liria dhe dinjiteti i personave (klientëve tanë) është i ruajtur. Ne jemi të detyruar të mbajmë sekretin lidhur me të gjitha çështjet e brendshme konfidenciale dhe informacionin konfidencial që ka të bëjë me klientët dhe partnerët tanë të biznesit. Detajet e marrëveshjes dhe sekretet e biznesit konsiderohen gjithashtu konfidencialë. Përgjegjësia për të ruajtur konfidencialitetin duhet të jetë edhe pas mbylljes së kontratës së punës. Në rast mosrespektimi dhe dhunimi, SHAFP ka të drejtën e marrjen e masave të nevojshme.

/5

Konkurenca-Sjellja e Përputhshmërisë

Ne jemi të bindur që është e domosdoshme dhe e rëndësishme për konkurrencën që të veprimet në mënyrë të ndershme për produktin që ne ofrojmë në treg.

Ne jemi pjesëmarrës në treg dhe si të tillë kemi nevojë për një treg që funksionon.

Si rezultat i performancës sonë të shkëlqyer ne jemi në atë nivel që të formësojmë tregun nëpërmjet inovacioneve dhe cilësisë. Ne po menaxhojmë Fondin e Pensioneve në përputhje të plotë me ligjet dhe rregullat e zbatuara brenda një kuadri ligjor të hapur dhe të ndershëm bazuar në integritet dhe në mirëbesim. Sipas këtyre rrethanave ne përjashtojmë praktika që dhunojnë principet bazë të konkurrencës dhe të tregut të lirë.

Veprime apo sjellje që nuk janë të drejta dhe kundër konkurrencës janë të ndaluara.

Sjellja jonë në konkurrencë duhet të jete e tillë që tregu të mos ndikohet negativisht nga marrëveshjet, keqpërdorimi i fuqisë së tregut ose përqendrimi i fuqisë së tregut.

Informacioni i brendshëm

Informacioni i brendshëm është një informacion i detajuar, vetëm për Shoqerine dhe Fondin.

Asnjë punonjës nuk duhet ti japë palëve të treta informacion të brendshëm ose konfidencial, që ka të bëjë me Fondin apo Shoqerine .

Po kështu rekomandimet për të blerë apo për të shitur këto informacione duhet të shmangen.

Cjithashtu edhe brenda Shoqerise , marrja dhe dhënia e informacionit të brendshëm dhe konfidencial midis kolegëve është e lejuar vetëm nëse ky lloj informacioni iu nevojitet për të realizuar detyrat që u janë ngarkuar me vete.

/6 Konflikti i Interesit

Shoqeria jone eshte e udhëhequr nga interesat e kompanisë dhe ne duhet të sigurohemi që interesat private nuk janë në konflikt me detyrimet tona në Shoqeri.

Një gërshetim i interesave personale me ato të Shoqerise në dëm të Fondit te Pensioneve është rreptësisht e ndaluar. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në: kontratat apo marrëveshjet me anë të të cilave ne apo të afërm, miq mund të kenë përfitime. Edhe një punë e dytë, punë këshilluese, funksione në institucione ligjore ose zyra politike në rrethana të caktuara mund të çojë në konflikt interesi. Çdo rast potencial i konfliktit të interesit duhet ti raportohet eprorëve dhe do ti nënshtrohet miratimit

/7 Komunikimi

Komunikim i ndershëm eshte Fokusi ynë kryesor, i plotë, i shpejtë, i saktë dhe i qartë në çdo fushë në përputhje me objektivat tona për të ecur përpara. Kjo duhet të respektohet dhe zbatohet nga të gjithë punonjësit, manaxherët, drejtorët, anëtarët e KA dhe Aksionerët e Shoqerise .

Ne mbështesim raportimet e ndershme dhe të vërteta brenda dhe jashtë kompanisë dhe duhet të jenë të besueshme për këtë arsye.

Komunikimi me mediat, aksionerët, autoritetet mbikqyrëse bëhet vetëm nga Administratorët e Shoqerise anëtarët e KA ose punonjësit e autorizuar nga to.

Çdo komunikim me mediat apo aksionerët duhet të miratohet paraprakisht brenda Shoqerise.

/8 **Siguria**

Çështja e sigurisë është shumë e rëndësishme për ne. Kjo vlen për njerëzit, për asetet fizike si dhe për vlerat dhe asetet intelektuale, të dhënat dhe parimet thelbësore. Menaxhimi krijon sistem personal, teknologjik, organizativ për mbrojtjen dhe sigurinë fizike të klientëve tanë dhe të stafit si dhe rritjen e sigurisë brenda ambienteve të kompanisë. Shmangia e rreziqeve fillon me njohjen e problemeve sipas sloganit “Shiko, vepro, trajto mos largo shikimin dhe mos neglizho”. Rreziqet e identifikueshme duhet tu raportohen eprorëve dhe personave përgjegjës për sigurinë. Standardet e sigurisë janë të mirëpërcaktuara me anë të masave të arsyeshme dhe devijimet duhen të eliminohen në mënyrën më të mirë të mundshme

/9 **Personat e kontaktit**

Çdo raport duhet të mbahet në mënyrë konfidenciale dhe, sipas kërkesave edhe në mënyrë anonime. SHAFP merr përsipër mbrojtjen e veçantë dhe mbështet të gjithë personat që ankohen ose raportojnë gjithçka me ndërgjegje të pastër dhe në besim të plotë. Personat e mëposhtëm janë disponibël për ju për çdo raportim të veprave jo ligjore apo rastet e shkeljes së Kodit të Sjelljes.

Administrator i Përgjithshëm
Z. Elvis Ponari

Cështje Ligjore dhe te Pajtueshmerise
z. Abdyl Sarja
abi.sarja@uniqa.al



Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit

E ardhmja jonë së bashku!

**Adresa: Rruga Donika Kastrioti, pranë Ambasadës së Kosovës dhe
asaj Zviceriane, Tiranë, Shqipëri**

Tel: +355 4 451 1666

E-mail: info@fppsigal.com.al

www.fppsigal.com.al